



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA
DEKANI

URDHËR
Nr 2 , Datë 12/01/2024

MBI KOMISIONIN AD HOC TË KONKURIMIT, PËR PUNONJËS MËSIMORË
“ASISTENT LEKTOR” NË PROGRAMIN E STUDIMIT FOTOGRAFI NË
FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV “Personeli i Institucioneve të Arsimit të Lartë“, urdhërin e Rektorit nr. 7, datë. 12/01/2024 “Mbi procedurat e konkurrimit për punonjës mësimorë në Fakultetin e Arteve të Bukura, për pozicionin e punës kategoria “Asistent lektor”, në Prog.Stud. Fotografi (Teknikat e Fotografisë dhe Fotografi me zgjedhje), pika 2, në cilësinë e Dekanit/titullarit të Fakultetit të Arteve të Bukura,

URDHËROJ:

- Miratimin e Komisionit Ad Hoc të konkursit punonjës për pozicionin e punës kategoria “Asistent Lektor”, në Prog.Stud. Fotografi (Teknikat e Fotografisë dhe Fotografi me zgjedhje), sa më poshtë vijon:
 - Dr. Ermir HOXHA Kryetar;
 - Prof. Asoc.Albes FUSHA Anëtar ;
 - Lek. Ilir BUTKA Anëtar ;
 - Lek. Petraq PAPA Anëtar ;
 - Msc. Elia PLAKU/ADEMI AnëtarDrejtor Menaxh.Burim.Njerëz UART;
- Komisioni të marrë masa për fillimin e konkurrimit për pozicionin e punës sa më lart, e cila do të jetë në sallat e Fakultetit më datë **17/01/2024** ora **10.00**;
- Ky urdhër u bëhet i njohur personave të përcaktuar në pikën 1 më sipër;

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Artan PEQINI


DEKAN

FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE IP-A



Nr. 1165 /2 , prot.

Tiranë, më 12/01/2024

URDHËR

Nr. 7 , Datë 12/01/2024

MBI PROCEDURAT E KONKURIMIT, PËR PUNONJËS MËSIMOR “ASISTENT LEKTOR” NË PROGRAMIN E STUDIMIT FOTOGRAFI (TEKNIKAT E FOTOGRAFIS, /FOTOGRAFI ME ZGJEDHJE) NJËSIA BAZË ARTE TË APLIKUARA, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Arteve, Shkresën e Rektoratit, Nr. 1165, datë 24/12/2023 “Mbi procedurat e konkurrimit për punonjës mësimor në Fakultetin e Arteve të Bukura, nga kategoria **As. Lektor, për Programin e Studimit Fotografi për lëndët: (Teknikat e Fotografisë/Fotografi me zgjedhje)** në UART”, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 103, të datës 26 Dhjetor 2023, duke patur në konsideratë faktin se marrja në punë e personelit në institucionet e AL kryhet me konkurim publik mbi bazën e shpalljes së vendeve të lira dhe përcaktimit të kriterëve për çdo vend pune, plotësimi i të cilave përbën kushtin themelor për konkurimin e kandidatëve dhe punësimin e tyre si punonjës mësimor, vlerësimi i dosjeve të kandidatëve konkures do të kryhen nga Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave (KVK), ngritur posaçërisht për këtë qëllim,

URDHËROJ:

1. Komisioni Ad-Hoc i vlerësimit të kandidaturave që konkurrojnë për punonjës mësimorë në Fakultetin e Artit Skenik , për pozicionin e punës “Asistent Lektor”, **për Programin e Studimit Fotografi për lëndët: (Teknikat e Fotografisë/Fotografi me zgjedhje)** ngrihet me Urdhër të Dekanit dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë;
2. Për ngritjen e komisionit, veprohet në këtë mënyrë:
 - a. 2 (dy) anëtarë të komisionit përzgjidhen nga Pergjegjësi Njesisë Bazë i cili i propozonë Dekanit;
 - b. 2 (dy) anëtarë të komisionit përzgjidhen nga Dekanit ku njëri prej tyre të jetë anëtar i njësisë bazë i cili ka shpallur procedurën e konkurrimit ;
 - c. 1 (një) anëtar emërohet nga Rektori përkatësisht Drejtorja e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore .



DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE IP-A

3. Komisioni ad hoc organizon, drejton dhe mbikqyr procedurat e zhvillimit të konkurrimit, shqyrton dosjet dhe vleron me pikë kandidaturat e paraqitura mbi bazën e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për këtë specialitet të publikuara dhe të shpallura publikisht nga Rektorati i Universitetit të Arteve.
Kryetari dhe anëtarët e Komisionit ad hoc janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit, duke filluar që nga marrja në dorëzim e dosjeve të kandidaturave, zhvillimin e konkurrimit deri në shpalljen e vendimit për vlerësimin, renditjen dhe përzgjedhjen e kandidaturave;
4. Komisioni ad hoc, duhet të përfundojë procedurat e konkurrimit të përcaktuar në urdhër, brenda 10 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij urdhëri;
5. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ndihmon Komisionin ad hoc, mbikqyr dhe kontrollon zhvillimin e procedurave të konkurrimit në përputhje me aktet ligjore të zbatueshme, si dhe njofton periodikisht Rektorin, për ecurinë e tyre. Në rastet kur vërehen shkelje, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore njofton menjëherë Rektorin, i cili mund të vendosë pezullimin e procedurave. Në përfundim të konkurrimit, DMBNJ i paraqet Rektorit një raport me shkrim mbi zhvillimin e procedurave të konkurrimit;
6. Çdo anëtarë i Komisioni ad hoc është i detyruar të shqyrtojë në mënyrë individuale të gjitha dosjet e prezantuara për konkurrim. Komisioni ad hoc bën vlerësimin e dosjeve duke përcaktuar pikët e fituara për çdo dosje;
7. Menjëherë pas përfundimit të vlerësimit të fazës së konkurrimit, Komisioni ad hoc bën mbledhjen e pikëve të fituara për secilin kandidat si dhe përcakton renditjen përfundimtare të kandidatëve sipas pikëve të fituara. Komisioni ad hoc, bën klasifikimin e konkurrentëve, të cilët kanë marrë mbi 60% të pikëve totale (vendosur nga Komisioni ad hoc). Kandidatët me më pak se 60% të pikëve konsiderohen të skualifikuar;
8. Vendimet e Komisionit ad hoc merren me shumicë votash. Anëtarët nuk lejohet të abstenojnë;
9. Renditja përfundimtare e kandidatëve shpallet publikisht nga Komisioni ad hoc;
10. Dekani i Fakultetit i paraqet Rektorit listën e kandidatëve sipas renditjes së pikëve të fituara. Rektori lidh Kontratën e Punës me kandidatin e përzgjedhur;
11. Kandidatët mund të ankohen tek Rektori për renditjen e pikëve shpallur nga Komisioni ad hoc, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e kësaj liste. Në këtë rast si dhe në rastet kur Rektori e çmon të nevojshëm verifikimin e procedurave të konkurrimit, dosja e plotë e konkursit i paraqitet menjëherë Rektorit nga Dekani i Fakultetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI



DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE IP-A

12. Në rastet e përcaktuara më lart, Rektori shqyrton dosjen e konkurimit dhe vendos sipas rastit:

- a. Të mos pranojë ankimin;
- b. Të kthejë dosjen e konkursit për rivlerësim;
- c. Të anulojë konkursin.

13. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Dekani dhe Komisioni ad hoc, për zbatimin e këtij urdhëri. Ky urdhër shpallet në mjediset e Fakultetit dhe u bëhet i njohur kandidatëve para fillimit të konkursit;

14. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot CAUSHI

REKTOR

UNIVERSITETI I ARTEVE



1000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1165 /2 , prot.

Tiranë, më 12/01/2024



URDHËR

Nr. 7/1 , Datë 12/01/2024

MBI PROCEDURAT E KONKURIMIT, PËR PUNONJËS MËSIMOR “ASISTENT L.EKTOR” NË PROGRAMIN E STUDIMIT FOTOGRAFI (TEKNIKAT E FOTOGRAFIS./FOTOGRAFI ME ZGJEDHJE) NJËSIA BAZË ARTE TË APLIKUARA, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Mbështetur në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV “Personeli i Institucioneve të Arsimit të Lartë“, Neni 64, në Statutin e Universitetit të Arteve, Urdhëri nr. 7 , datë 12/01/2024 “Mbi procedurat e konkurrimit për punonjës mësimor në Fakultetin e Arteve të Bukura, nga kategoria **As. Lektor,për Programin e Studimit Fotografi për lëndët: (Teknikat e Fotografisë/Fotografi me zgjedhje)** në UART”, në cilësinë e titullarit të Institucionit,

URDHËROJ:

1. Msc. Elia PLAKU, me detyrë Drejtor i DMBNJ, caktohet anëtar i Komisionit ad hoc për konkursin punonjës mësimor në Arteve të Bukura, për pozicionin e punës “Asistent Lektor”;
2. Ky urdhër u bëhet i njohur personave të përcaktuar në pikat 1, më sipër;

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Kastriot ÇAUSHI

REKTOR

UNIVERSITETI I ARTEVE

2019-2020



V E N D I M

I KOMISIONIT AD HOC MBI KONKURSIN PËR PUNONJËS MËSIMOR “ASISTENT LEKTOR” NË PROGRAMIN E STUDIMIT FOTOGRAFI (TEKNIKAT E FOTOGRAFISË /FOTOGRAFI ME ZGJEDHJE) NJËSIA BAZË ARTE TË APLIKUARA NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Sot më datë 17/01/2024 mbështetur në Proces Verbalin e vlerësimit të konkursit për punonjës mësimor “Asistent Lektor”, në Prog.Stud.FOTOGRAFI, Komisioni sa më poshtë:

1. **Lek. Ermir HOXHA** Kryetar (Përgjegjës i Njesisë Bazë)
2. **Prof. Asoc.Albes FUSHA** Anëtar
3. **Lek. Ilir BUTKA** Anëtar
4. **Lek. Petraq PAPA** Anëtar
5. **Msc. Elia PLAKU/ADEMI** Anëtar (Dr.DMBNJ,përfaqësues nga Rek)

mbështetur në Urdhërin e Rektorit, (konkurrentin mbi 60 pikë e përcjellim në rektorat)

V E N D O S I :

ORESTIA KAPIDANI 95.4 pikë

MARSIOLA SARAÇI 36.16 pikë

Komisioni Ad Hoc i Vlerësimit të Kandidatëve

Lek. Ermir HOXHA

Kryetar

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Anëtar

Lek. Ilir BUTKA

Anëtar

Lek. Petraq PAPA

Anëtar

Msc. ELIA PLAKU/ADEMI

Anëtar

